UDHËZIM
Nr. 39, datë 6.10.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 18.8.2015, "PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, SI DHE KANDIDATËT SHQIPTARË NGA MAQEDONIA, MALI I ZI, PRESHEVA, BUJANOVCI DHE MEDVEGJA, NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2015–2016"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 33, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015–2016", si dhe në zbatim të vendimit nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", të ndryshuar, vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)", si dhe vendimit nr. 241, datë 31.3.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për kryerjen nga Posta Shqiptare, sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 26, datë 18.8.2015, "Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit për kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015–2016", të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 6, datë "22 shtator 2015" zëvendësohet me datën "7 tetor 2015";

b) Në pikën 7, periudha "23 shtator deri 1 tetor 2015" zëvendësohet me periudhën "deri më 15 tetor 2015", dhe data "2 tetor 2015" zëvendësohet me datën "16 tetor 2015";

c) Në pikën 9, data "6 tetor 2015" zëvendësohet me datën "22 tetor 2015";

d) Në pikën 10, periudha "7 tetor 2015 deri më 12 tetor 2015" zëvendësohet me periudhën "23 tetor 2015 deri më 27 tetor 2015" dhe data "16 tetor 2015" zëvendësohet me datën "30 tetor 2015".

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla